



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:062366

Datë: 14.02.2022

Numri i dokumentit: 02710557

PS.nr.41/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË Departamenti Special trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët, Lutfi Shala kryetar, Vesel Ismaili dhe Kujtim Krasniqi anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Rovena Kastrati, duke vendosur në çështjen penale kundër të akuzuarit K.P për shkak të veprës penale shtytja për kryerjen e veprave terroriste në vazhdimësi nga neni 134 lidhur me nenin 77 të KPRK- së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.57/2019, të datës 24.09.2021, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, i hapur për publikun, ku prezentë ishin Prokurori i Prokurorisë Speciale Afrim Shefkiu, i akuzuari K. P. dhe mbrojtësi i tij, av. Vigan Rugova nga Prishtina, gjykata me datë 24.12.2021 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

K.P. nga i ati F., dhe nëna H. e gjinisë S. me nofkën ‘‘E. Z. E. K.’’ i lindur me ... në fshatin K. Komuna e L., ka të kryer shkollën e mesme, i divorcuar, i gjendjes se dobët ekonomike shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, **ka qen nën masën e paraburgimit prej dt: 30.06.2021** e deri më dt: **24.12.2021**

ËSHTË FAJTOR

I. Sepse me datë ..., përmes kanalit ‘‘N. I.’’, në aplikacionin ‘‘T.’’ duke vepruar me paramendim dhe me dashje i është përgjigjur thirrjes së kreut të ISIS-it E. B. A.B., në përkrahje të kryerjes së veprave terroriste që ka postuar një video incizim me përmbajtje ‘‘O E. B. E. B., o tmerrues i armiqve, krahët e mijë që po thërret tashmë janë të lirë për të më regjistruar si shehid ‘’ dhe në këtë mënyrë shkakton rrezikun që një ose më shumë vepra të tilla të kryhen.

II. Se i pandehuri K.P. nga dt.. deri më dt.. përmes rrjetit social ‘‘T.’’ në kanalën e tij ‘‘N. im’’, me paramendim dhe me dashje duke qen mbështetës i organizatës terroriste ISIS në vazhdimësi ka bërë thirrje përkrahësve të tij në kryerjen e akteve terroriste ashtu që :

- Më dt... përmes kanalit të lartë përmendur poston videon me përmbajtje ‘‘më mirë të vdesësh në këmbë se të jetosh në gjunjë’’ ku paraqet një dorë të përgjakur dhe një thikë. Po ashtu me të njëjtën datë poston video incizimin me ilahi në gjuhën arabe ku paraqet vëllain e tij B. P. duke kryer sulm vetëvrasës me automjet të mbushur me eksploziv ndaj ushtarëve amerikan në Siri.

-Më dt 04.11.2020 përmes kanalit të lartë përmendur ka postuar një video me përmbajtje inkriminuese lidhur me personin që ka kryer sulmin terrorist në V. të A. ku dëgjohet një person i armatosur me armë të zjarra dhe me shpatë si dhe me flamurin e ISIS-it, duke folur në gjuhën shqipe, duke iu drejtuar myslimaneve me fjalët ‘‘ të mos shqetësohen për mizorinë që bëhet ndaj tyre’’, ‘‘ duhet durim se do të ju vijë fundi me emrin e Allahut, do t’ju vijë fundi atyre mbretërve që po vrasin myslimane, bëni durim se do të vijë fitorja’’.

-Me dt. ... po ashtu përmes kanalit të lartë përmendur ka postuar fotografinë e ushtarit të organizatës terroriste ISIS me flamurin e ISIS-it në thënien “ pasha Allahun nuk do të ndalemi deri sa të trokas gozhdë e fundit në arkivolin e çdo taghuti”.

-Me dt. poston fotografinë me përmbajtje të thirrjes për akte terroriste ku shifet duke iu prerë koka presidentit F..

-Me dt.... poston fotografinë me përmbajtje të thirrjes për aktet terroriste ku shifet një ushtarë i organizatës terroriste ISIS i cili ka vendosur këmbën mbi kokën e prerë të një personi dhe mbishkrimin “ unë do të shtijë frikën në zemrat e mohuesve andaj goditni në qafë dhe në të gjithë gishtërinjtë”.

-Me dt. ... paraqet fotografitë e luftëtarit të ISIS-it me armë si dhe me flamur të ISIS-it duke dhënë betimin për hakmarrje dhe duke ngritur flamurin e organizatës terroriste ISIS në xhaminë El-aksa me këtë përmbajtje: “ do të hakmerremi së shpejti! Dhe nesër me lejen e Allahut do të jemi në B.-makdis, dhe flamuri i zi i Teuhidit do të valëvitet mbi xhaminë El-aksa”

- Me këto veprime ka kryer veprën penale Shtytja për kryerjen e veprave terroriste në vazhdim nga neni 134 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 7, 8, 9, 10, 17, 38, 39, 40, 42, 69, 77, 79, të KPRK-së, si dhe nenit 360, 361 dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME BURGIM

Ashtu që të akuzuarit **K. P.** i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje **2 (dy) vite, e 6 (gjashtë) muaj,** të cilin dënim do ta vuajë 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi,

Koha e kaluar nën masën e paraburgimit prej datës **30.06.2021** e deri më dt: **24.12.2021** i llogaritet në dënimin e shqiptuar.

OBLIGOHET i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor shumë prej **100 euro**, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave shumë prej **50 euro**.

Me Aktvendim të veçantë **PS.nr.41/2021 të datës 24.12.2021**, gjykata të akuzuarit i ndërpret masën e paraburgimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës pran kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzë PPS.nr.57/2019 të dt.24.09.2021, kundër të akuzuarit **K. P.** për shkak të veprës penale shtytja për kryerjen e veprave terroriste nga neni 134 të KPRK-së dhe veprës penale shtytja për kryerjen e veprave terroriste në vazhdimësi nga neni 134 lidhur me nenin 77 të KPRK- së.

Gjykata Themelore në Prishtinë –Departamenti Special ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 23.12.2021, ku prezent ishin Prokurori i Prokurorisë Speciale Afrim Shefkiu, i akuzuari K.P. dhe mbrojtësi i tij, av. Vigan Rugova.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor i akuzuari në bazë të nenit 323 të KPRK-së, është udhëzuar me të drejtat e tij ligjore dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorisë Themelore në Prishtinë në bazë të nenit 326 par.1 të KPRK-së, mbi të drejtat mbi deklarinimin e pranimit apo mos pranimit të fajësisë, në këtë drejtim i akuzuari është njoftuar nga gjykata për pasojat që rezultojnë nga pranimi i fajësisë dhe kushtet e përcaktuara me nenin 248 par.1 pika 1.1 deri 1.3 të KPRK-së, që pranimi nga ana e tij të konsiderohet i vlefshëm

I akuzuari në shqyrtimin gjyqësor të datës 23.12.2021 ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet, andaj gjykata ka vazhduar me procedimin e provave.

Prokurori i PSRK-së Afrim Shefkiu, para se të vazhdoj me fjalën përfundimtare konfrom neni 350 par.1 të KPPRK-së, ka bërë precizimin e akuzës ashtu që nga dispozitivi i parë ka hequr cilësimin e veçantë “Shtytja për kryerjen e veprave terroriste nga neni 134 të KPRK-së” ndërkaq përshkrimi faktik është bart në dispozitivin e dytë e që mbetet një dispozitiv ashtu që pas pasuesit të parë përkatësisht pas fjalëve në kryerjen e akteve terroriste bartet përshkrimi faktik i dispozitivit të parë e që në fund mbetet kualifikimi i veprës siç është në aktakuzës “*Shtytja në kryerjen e veprave terroriste në vazhdim nga neni 134 lidhur me nenin 77 të KPRK-së*”

Meqenëse Prokurori Special bëri rikualifikimin e veprës penale, dhe atë shkruar dispozitivin të parë në një dispozitiv të aktakuzës kryetari i trupit gjykues i’ a dha të drejtën edhe një herë të akuzuarit që të deklarohet lidhur me ndryshimin e kualifikimit të veprës penale, si dhe në bazë të nenit 326 par.1 të KPRK-së udhëzoi të akuzuarin edhe njëherë mbi të drejtat rreth deklaramit dhe pranimit apo mos pranimit të fajësisë, në këtë drejtim i akuzuari është njoftuar nga gjykata për pasojat që rezultojnë nga pranimi i fajësisë dhe kushtet e përcaktuara me nenin 248 par.1 pika 1.1 deri 1.3 të KPPRK-së, që pranimit nga ana e tij të konsiderohet i vlefshëm.,

I akuzuari K.P u deklarua se edhe pse prokurori e bëri rikualifikimin e veprës penale, prapë deklarohem se nuk e ndjej vetën fajtorë për veprën penale të rikualifikuar nga Prokurori Special.

Trupi Gjykues pas deklaramit të akuzuarit për fajësinë ftoi prokurorin e Prokurorisë Speciale që ta paraqesë fjalën përfundimtare.

Prokurori i Prokurorisë Speciale gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi prapa aktakuzës së ndryshuar ngase edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor pa mëdyshje është vërtetuar se i njëjti ka kryer veprën penale që i vihet në barrë kjo gjendje faktike në mënyrë të qartë dhe bindëse është vërtetuar me administrimin e provave materiale edhe atë me provat materiale të propozuar si në aktakuzë dhe të administruara në shqyrtim gjyqësor. Veçmas nga të gjeturat nga raportet njoftuese të policisë së Kosovës DKT në Prishtinë vërtetohet qartë se i akuzuari ka qenë haptas përkrahës i ideologjisë dhe veprimeve terroriste të organizatës ISIS e po ashtu nga provat e administruar rezultoi se i pandehuri në fjalë nga komunikimet e gjetura me personat e tjerë shihet qartë se proklamoi dhe shpërndan propagandën për organizatën terroriste ISIS rreth krijimit të shtetit të sunduar nga Sheriati po ashtu nga këto prova përkatësisht nga dëshmitë e nxjerra nga dëshmitë e D.1 dhe D.2, përkatësisht nga telefonat e të pandehurit shihen fotografi dhe video incizime e postuar në kanalin e aplikacionit telegram, “N.”, i cili menagjohet nga i pandehuri e që këtë fakt e konfirmoj edhe i pandehuri se është mengjues i këtij kanali, po ashtu nga fotografitë shihet qartë komunikimet-postimit e veçmas nga video incizimet dhe vërehen fotografi dhe video të vëllait të tij të ndjerë B.P. gjatë qëndrimit të tij në luftërat e S., ku edhe kishte kryer sulm vetëvrasës, me këto fotografi dhe video të postuar nga K. P. madhërohet vetë flijimi i vëllait të tij e të cilin e quajnë Sh., e ky veprim i tij konfirmon se i pandehuri ka qenë propagandues “i veprës së vëllait të tij” duke bërë haptas thirrje ndjekësve të kanalit të tij për kryerjen akteve terroriste, po ashtu nga komunikimet e nxjerra përmes aplikacionit telegram u vërtetua se i njëjti në vazhdimësi ka shpërndarë materiale propaganduese të organizatës ISIS dhe në kanalin e tij telegram i njëjti ka mbajtur të informuar përkrahësit e tij me të gjitha zhvillimet e ISIS-it në terren duke e ngritur moralin e ndjekësve me fotografi, informacione dhe video-incizime për qëllim të njëjta si “H. E.”, agjencia e mediave ISIS “A.” dhe kanaleve tjera me përkrahje të organizatës terroriste ISIS, konsumojmë me plotë të drejtë se në rastin konkret janë përmbushur të gjitha tiparet e veprës penale Shtytja në kryerjen veprave terroriste në vazhdim nga neni 134 lidhur me nenin 77 të KPRK-së e që mund të interpretohet gabimisht nga pala mbrojtëse elementi i shtytjes por që në rastin konkret kjo vepra penale është sanksionuar specifikisht dhe paraqet rrezik që të kryejnë vepra terroriste nga personat e tjerë. I akuzuari në fjalë edhe më parë ka qenë i gjykuar me aktgjykim të plotfuqishëm me nr. PKR.nr.9/18 të dt.30.01.2018, për shkak të veprës penale të këtij lloji, dhe propozojmë që i njëjti të shpallet fajtor dhe të gjykohet me një dënim meritore për këtë vepra penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit K. P., Av.Vigan Rugova, në fjalën përfundimtare deklaroi se me aktakuzën Prokurorit special i akuzuari K. P. akuzohet për kryerjen e veprës penale Shtytje për kryerjen veprave terroriste më hollësisht të përshkruara në aktakuzë si dhe ndryshimin e aktakuzës të paraqitur nga prokurori special të paraqitur gjatë shqyrtimit gjyqësor. Nga shqyrtimi kryesor nga provat materiale të lexuara dhe dispozitat ligjore u provua se asnjë nga pretendimet e prokurorit special të paraqitura në aktakuzë nuk qëndrojnë. Mbrojtja e kundërshtojnë akuzën si dhe provat e paraqitura në aktakuzë për arsyet e theksuara edhe në kundërshtimin e aktakuzës. Nga e njëjta nuk mund të krijohet dyshimi i bazuar dhe nuk u provua se i akuzuari ka kryer veprën penale pasi që asnjë nga elementet e kësaj veprë penale nuk është konsumuar me veprimet e të akuzuarit, ashtu siç i kemi theksuar edhe në fjalën hyrëse, respektivisht nuk është provuar se i akuzuari ka bërë thirrje publike ose me anë të mjeteve të informimit për kryerjen e veprës penale, nuk ekziston shtytja e posaçme, specifike e cila do të krijonte mundësinë që personi tjetër të bindet për kryerjen veprave terroriste, dhe në rasti konkret nuk ka ndonjë person që është shtytë për të kryer akte të tilla. Lidhur me deklaramet e prokurorit special theksojmë se përgjegjësia penale është përgjegjësi personale dhe individuale dhe se këtu i akuzuari nuk mund të i m veshën vepra të kryera nga ndonjë anëtarë i familjes, dhe kërkojmë nga gjykata që gjatë vendosjes që të mos i merr për bazë këto deklarime të prokurorit. Nga të lartcekurat i propozojmë gjykatës që të akuzuarin K. P. ta liroj nga aktakuza në kuptim të pikës 1.3 të par.1 të nenit 363 të KPPRK-së, pasi që nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Ndërsa sa i përket masës së paraburgimit i propozoj gjykatës që e njëjta të zëvendësohet me ndonjë masë më e butë dhe të akuzuarit ti ndërpritet masa e paraburgimit.

I akuzuari **K. P.**, në fjalën përfundimtare deklaroi se e mbështet deklaramet e mbrojtësit tim, dhe nuk kam çfarë të shtoj tjetër.

Në shqyrtimin gjyqësor publik gjykata konform nenit 7 të KPPK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plot vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrje të vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimale profesional dhe përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarit, si dhe ato favor të tij, duke i mundësuar të akuzuarit shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

Pas procedimit të provave materiale dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëra me tjetrën në kuptim të nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, gjykata gjeti se qëndrojnë elementet e veprës penale Shtytja për kryerjen e veprave penale terroriste në vazhdim nga neni 134 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, ashtu që në tersi u vërtetua se i akuzuari K. P.ka kryer veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ketë gjendje faktike e ka vërtetuar gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor me administrimin e provave materiale të cilat gjykata i ka administruar të tilla si: Raporti Informuesi i Policisë së Kosovës DTK në Prishtinë me nr. Ref. ... të datës ..., Raporti mbi të gjetura mbi aktivitetin kriminal të të pandehurit K. P. të datës .. bashkangjitur kallëzimit penal me nr. Ref. ..., Raporti njoftues i Policisë së Kosovës DTK në Prishtinë me nr. ref .. të dt..., Raporti njoftues i Policisë së Kosovës DTK Prishtinë me nr.ref. ..., Raporti njoftues i Policisë së Kosovës DTK në Prishtinë me nr.ref. i datës .., Raporti njoftues i Policisë së Kosovës DKT në Prishtinë me nr.ref. ... i datës .., Raporti mbi Implementimin e masave të fshehta të vëzhgimit dhe hetimit nga Policia e Kosovës DKT në Prishtinë me nr.ref. i datës 01.04.2021, Raporti mbi Implementimin e masave të fshehta të vëzhgimit dhe hetimit nga Policia e Kosovës DKT në Prishtinë me nr. ref.... i datës ..., Raporti mbi Implementimin e masave të fshehta të vëzhgimit dhe hetimit nga Policia e Kosovës DKT në Prishtinë me nr. ref. .. i datës ..., Raporti përmbledhës i bërë nga Policia e Kosovës DKT në Prishtinë me nr. Ref... i datës ..., Raporti njoftues mbi implementimin e Urdhër Kontrollit të shtëpisë dhe objekteve përcjellëse të të pandehurit i bërë nga Policia e Kosovës DKT në Prishtinë me nr. ref. ... i datës ..., Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve dhe procesverbali mbi bastisjen e shtëpisë dhe objekteve përcjellëse të të pandehurit me nr. rastit .. të datës ..., Raporti njoftues i Policisë së Kosovës DKT në Prishtinë me nr. ref. ... i datës ... mbi të gjeturat dhe analizën e pajisjeve të Teknologjisë Informative e të bëra nga eksperti i Teknologjisë Informative nga Drejtoria të

Teknikës Kriminalistike të Policisë së Kosovës në Prishtinë- Sektori për Fotografi, Video Analizë dhe Ekzaminim e të TI-së, Njësisë për Ekzaminim e Pajisjeve të Teknologjisë së Informacionit, të bashkangjitura edhe dy (2) CD, Nëntë (9) CD me përmbajtje inkriminuese sipas raporteve të Policisë së Kosovës DKT në Prishtinë si dhe foto dokumentacioni që gjendet në shkresa të lëndës të gjitha këto gjykata i ka vlerësuar si prova të pranueshme andaj i ka administruar si të tilla.

I akuzuari K. P. në shqyrtimin gjyqësor kanë shfrytëzuar të drejtën e mbrojtjes në heshtje.

Si është potencuar dhe vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata në këtë çështje penale mori aktgjykim dënues për të akuzuarin K.P dhe të njëjtin e ka shpallur fajtor për veprën penale shtytja për kryerjen e veprave terroriste në vazhdimësi nga neni 134 lidhur me nenin 77 të KPRK, ku kjo dispozitë ligjore ka përcaktuar se **”Kushdo që shpërndan, ose në ndonjë mënyrë tjetër mundëson me çdo mjet, mesazhin për publikun, me qëllim që të shtytë kryerjen e aktit terrorist, kur sjellja e tillë pavarësisht nëse avokon drejtpërdrejtë ose jo aktet terroriste, shkakton rrezikun që një ose më shumë vepra të tilla të kryhen, dënohet...”**

Ky formulim, është formulim ligjor të cilin e ka përdorur ligji tek vepra penale e shtytjes për kryerjen e veprave terroriste, e për tu konsideruar përgjegjës për këtë veprë penale, në çdo rast kryerësi i veprës penale duhet në veprimet e veta ti konsumoj elementet e kësaj veprë penale.

Si është theksuar edhe më lartë për tu konsideruar e kryer kjo veprë penale, kryerësi i saj duhet që të shpërndanë apo në çfarëdo mënyre e mjeti tjetër ti mundësoj publikut mesazhin me qëllim të shtytjes për kryerjen e aktit terrorist. Gjykata konsideron se i akuzuari K.P., në raport me këtë element të veprës penale, me publikimet e bëra në kanalën “N. Im” në aplikacionin “T.” ka konsumuar këtë element të veprës penale.

I akuzuari K. P., me datën ..., përmes kanalit “N. Im” në aplikacionin “T.” është përgjigjur thirrjes së kreut të ISIS-it E.B. A. B., në përkrahje të kryerjes së veprave terroriste dhe ka postuar një video incizim me përmbajtje **”O E. B. E. B.t, o tmerrues i armiqve, krahët e mijë që po thërret tashmë janë të lirë për të më regjistruar si shehid ”** ky fakt vërtetohet përmes provave materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor (raportet njoftuese). Nga përmbajtja e këtij mesazhi të përcjellë në këtë postim në kanalën “N. I.” në aplikacionin “T.” i akuzuari e shpreh me admirim përkrahjen e tij ndaj kreut të ISIS-it **E.B. E. B.**, dhe përgjigjet me gadishmeri ndaj thirrjes së tij kryerjen e akteve terroriste duke e bërë në mënyrë publike dhe me mjete të informimit publik siç është aplikacioni “T.” që është i ndjekur nga një numër i konsiderueshëm njerëzish, me qëllim që të ndikojë tek personat e tjerë me qëllim që të kryejnë akte terroriste. I akuzuari K. P., po ashtu përmes kanalit “N. I.” në aplikacionin “T.” bënë propagandimin dhe përkrahje për organizatën terroriste ISIS dhe nxit urrejtje kundër institucioneve të sigurisë dhe të gjithë të tjerëve që nuk mendojnë njëjtë si ISIS-i, të gjitha këto i shpreh përmes shkrimeve, audiove dhe video-incizimeve në kanalën e tij të cilin edhe e ka administruar.

Po ashtu i akuzuari përmes kanalit të lartpërmendur më dt: ..., poston videon me përmbajtje **”me mirë të vdesësh në këmbë se të jetosh në gjuhë”** ku paraqitet një dorë e përgjakur dhe një thikë. Në të njëjtën datë poston video incizimin me ilahi në gjuhën arabe ku paraqet vëllain e tij B. P. duke kryer sulm vetëvrasës me automjet të mbushur me eksploziv ndaj ushtarëve amerikanë në Siri. Këto pretendime u vërtetuan nga raportet njoftuese të administruara në shqyrtimin gjyqësor ku shihen qartë edhe fotografitë të shpërndara me qëllim të promovimit dhe shtytjes në drejtim të akteve terroriste, përmes martirizimit ku i akuzuari në shkrimin e paraqitur në fotografi shprehet me fjalët **”Allahu e pranofitë”** në këtë mënyrë i njëjti i pranon dhe përkrah veprime të tilla terroriste dhe kamikazë që qojnë drejt vetëfljimit si dhe vdekjes së një numri të konsiderueshëm dhe të papërcaktuar të njerëzve.

Gjykata po ashtu vërtetoi se i akuzuari K. P., me dt. ... përmes kanalit “N. I.” në aplikacionin “T.” ka postuar një video me përmbajtje inkriminuese lidhur me personin që ka kryer sulmin terrorist në Vienë ku dëgjohet një person i armatosur me armë të zjarrit dhe me shpatë si dhe me flamurin e ISIS duke folur në gjuhën shqipe duke iu drejtuar myslimanëve me fjalët **”të mos shqetësohen për mizorinë që bëhej ndaj tyre”, “duhet durim se do t’ju vijë fundi me emrin e Allahut, do t’ju vijë fundi atyre mbretërve që po**

vrasin mysliman, bëni durim se do të vijë fitorja". Shihet qartë se i akuzuari përmes këtyre postimeve ju bën thirrje ndjekësve të kanalit "N.I." në aplikacionin "T." që të bëhen të duruar pasi që shumë shpejt për ta do të ketë fitore duke evidentuar qëllimin e tij për durim dhe bashkim të një numri sa e të madh në kryerjen e akteve terroriste.

Më datë .. i akuzuari K. P., po ashtu përmes kanalit "N. I.", ka postuar fotografinë me përmbajtje të ushtarit të organizatës terroriste ISIS me flamurin e ISIS-it në të cilën thuhet "*Pasha Allahun nuk do të ndalemi derisa të trokas gozhdë e fundit në arkivolin e cdo taghuti*". Gjykata vërtetoi se përmes këtij mesazhi i akuzuari përforcon qëllimin e tij në shtytje për të mos u ndalur derisa të bjerë edhe i fundit dhe për hakmarrje duke u betuar në përmbushje të synimit kryesor të akteve terroriste përmes pushtimit dhe me qëllim të ngritjes së flamurit të organizatës terroriste ISIS si fitimtare.

Gjykata ka vërtetuar se i akuzuari këto thirrje në drejtim të akteve terroriste i ka përforcuar edhe përmes fotografisë në të cilën shihet një person duke iu prerë koka me mbishkrimin "*Luftoi jobesimtarët dhe hipokritët dhe sillu rreptë /ashpër ndaj tyre*". Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoi edhe përmes fotografisë të postuar në kanal dhe larte përmendur me datë .. ku shihet një ushtar i organizatës terroriste ISIS i cili ka vendosur këmbën e tij mbi kokën e prerë të një personi dhe me mbishkrimin "*Unë do të shtijë frikë në zemrat e mohuesve andaj goditni në qafë dhe në të gjithë gishtërinjtë*" përmes të cilës fotografi gjykata gjeti se evidentohet qartë manifestimi i shprehjes së nxitjes dhe shtytjes të personave të tjerë për akte me qëllime terroriste.

Po ashtu gjykata këtë gjendje faktike e ka vërtetuar edhe përmes thënies se postuar me fotografi me mbishkrim "*Pasha Allahun, do të hakmerremi së shpejti! Dhe nesër me lejen e Allahut do të jemi në B.-M., dhe flamuru i zi i T.t do të valvitet mbi xhaminë E.-A.*" të dt:..., në këtë mënyrë përmes këtij mesazhi i akuzuari përforcon qëllimin e tij në shtytje për hakmarrje duke u betuar në përmbushje të synimit të akteve terroriste përmes pushtimit dhe me qëllim të ngritjes së flamurit të organizatës terroriste ISIS.

Në rastin konkret shtytja apo thirrja e të akuzuarit K. P., për kryerjen e veprave terroriste, nuk është përmbyllur me kryerjen e ndonjë veprë apo akti terrorist, mirëpo edhe pse nuk është përmbyllur me ndonjë aktivitet terrorist, i akuzuari ka konsumuar në tërësi me veprimet e veta elementet inkriminuese të veprës penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari ka konsumuar në veprimet e veta elementet e veprës penale për të cilën akuzohet, për faktin se i njëjti ka bërë shtytjen për kryerjen e veprave terroriste dhe se kjo vepër penale (shtytja për kryerjen e veprave terroriste) në elementet objektive të saja nuk kërkon që ata (publiku) të cilët janë shtytur të kryejnë ndonjë akt terrorist, pra nuk duhet patjetër të kryejnë ndonjë vepër terroriste apo akt terrorist. Bazuar në përshkrimin ligjor të veprës penale mjafton që vetëm të përcillet apo mundësohet mesazhi për publikun me përmbajtje shtytëse për kryerjen e ndonjë veprë terroriste apo akti terrorist edhe pse nuk avokon në veprën penale apo kryerjen e veprës penale, pra mjafton vetëm të përcillet mesazhi me përmbajtje shtytëse, e ku i akuzuari K.P., ka përcjellë këtë mesazh përmes kanalit "N. I." në aplikacionin "T.".

E rëndësisë së posaçme është të përmendet dhe shtjellohen video-incizimet dhe fotot e postuara dhe të nxjerra nga llogaria e të akuzuarit në kanal "N. I." në aplikacionin "T.", ku i akuzuari përpos postimit të tekstit apo mesazhit me përmbajtje shtytëse për kryerjen e veprave terroriste, ka postuar edhe video e foto të cilat përmbajnë në tërësinë e tyre imazhe dhe sekuenca nga veprimtaria e organizatës terroriste ISIS. Me këtë postim të videove dhe fotove të ISIS, ka përcjellë mesazhe përkrahëse dhe nxitëse drejt organizatës terroriste ISIS, edhe pse postimi i këtyre videove e fotove nuk futet në sferën kriminale, tregon se i akuzuari ka pasur si qëllim që të krijohet mundësia që personi tjetër të bindet për të kryet vepra terroriste.

Gjykata vlerësoi me shumë kujdes të gjitha provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, dhe ka ardhur në përfundim se duhet t'i falet besimi i plotë, provave të cilat gjykata i ka administruar si: Raporti Informuesi i Policisë së Kosovës DTK në Prishtinë me nr. Ref. .. të datës ..., Raporti mbi të gjetura mbi

aktivitetin kriminal të të pandehurit K. P. të datës ... bashkangjitur kallëzimit penal me nr. Ref. ..., Raporti njoftues i Policisë së Kosovës DTK në Prishtinë me nr. ref .. të dt..., Raporti njoftues i Policisë së Kosovës DTK Prishtinë me nr.ref. ..., Raporti njoftues i Policisë së Kosovës DTK në Prishtinë me nr.ref. ...i datës ..., Raporti njoftues i Policisë së Kosovës DKT në Prishtinë me nr.ref. ... i datës ..., Raporti mbi Implementimin e masave të fshehta të vëzhgimit dhe hetimit nga Policia e Kosovës DKT në Prishtinë me nr.ref. ... i datës ..., Raporti mbi Implementimin e masave të fshehta të vëzhgimit dhe hetimit nga Policia e Kosovës DKT në Prishtinë me nr. ref... i datës ..., Raporti mbi Implementimin e masave të fshehta të vëzhgimit dhe hetimit nga Policia e Kosovës DKT në Prishtinë me nr. ref. ... i datës ..., Raporti përmbledhës i bërë nga Policia e Kosovës DKT në Prishtinë me nr. Ref. i datës ..., Raporti njoftues mbi implementimin e Urdhër Kontrollit të shtëpisë dhe objekteve përcjellëse të të pandehurit i bërë nga Policia e Kosovës DKT në Prishtinë me nr. ref. ... i datës ..., Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve dhe procesverbali mbi bastisjen e shtëpisë dhe objekteve përcjellëse të të pandehurit me nr. rastit ... të datës ..., Raporti njoftues i Policisë së Kosovës DKT në Prishtinë me nr. ref. ... i datës ... mbi të gjeturat dhe analizën e pajisjeve të Teknologjisë Informative e të bëra nga eksperti i Teknologjisë Informative nga Drejtoria të Teknikës Kriminalistike të Policisë së Kosovës në Prishtinë- Sektori për Fotografi, Video Analizë dhe Ekzaminim e të TI-së, Njesisë për Ekzaminim e Pajisjeve të Teknologjisë së Informacionit, të bashkangjitura edhe dy (2) CD, Nëntë (9) CD me përmbajtje inkriminuese sipas raporteve të Policisë së Kosovës DKT në Prishtinë dhe foto dokumentacioni që gjendet në shkresa të lëndës të gjitha këto gjykata i ka vlerësuar si prova të pranueshme andaj i ka administruar si të tilla, dhe të njëjtave i'u ka falur besimin e plot.

Gjykata duke pasur parasysh të gjitha provat e proceduara, faktet dhe rrethanat e vërtetuara, ne shqyrtim gjyqësor, ka mundur ta vërtetojë se i akuzuari K. P., ka kryer veprën penale për të cilën ai akuzohet, pasi që i njëjti i ka konsumuar të gjitha elementet e veprës penale; shtytja për kryerjen e veprave terroriste në vazhdimësi nga neni 134 lidhur me nenin 77 të KPRK- së, pasi që i akuzuari ka pasur qëllim – dashje për të krijuar mundësinë që personat e tjerë të binden për kryerjen e veprave terroriste e në rastin konkret nuk duhet patjetër që i akuzuari të kryejë ndonjë vepër terroriste apo akt terrorist por vepra konsiderohet se është kryer dhe është përfunduar me vetë faktin e ndërmarrjes së veprimit me qëllim që të ndikohet tek personat e tjerë që të kryejnë akte të tilla. Andaj gjykata bazuar në provat e administruara në shqyrtim gjyqësor si dhe faktet dhe rrethanat e vërtetuara përmes provave, vlerësoi se pretendimet e prokurorisë janë tërësisht të bazuara dhe se i akuzuari K. P., ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për ashpërsimin e dënimit, ka gjetur, **shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale**, pasi që i njëjti në mënyrë të vazhdueshme ka postuar fotografi dhe video-incizime në kanalën "N. I." në aplikacionin "T." me mbishkrime dhe përmbajtje shtytëse në drejtim të kësaj vepre penale, **shkallën e lartë të dashjes** pasi që i akuzuari në mënyrë të vazhdueshme ka bërë thirrje përmes postimeve duke pasur si qëllim të shtytë dhe të inkurajojë personat e tjerë në kryerjen e akteve terroriste, **intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur** siç rezulton kjo vepër penale ka synim ruajtjen e shoqërisë nga cenimi dhe rrezikimi i kryerjes së veprave dhe akteve terroriste, **i akuzuari është recidivist** pasi që i njëjti është dënuar me aktgjykim të formës prerë nga Gjykata Themelore në Prishtinë me nr. PKR.nr.9/2018 i plotfuqishëm me datë 04.03.2018.

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për zbutjen e dënimit, për të akuzuarin ka gjetur; **mosha e personit të dënuar** pasi që i njëjti është i moshës relativisht të re, **fakti që personi i dënuar ka marrë pjesë në veprën penale jo si kryes kryesor por përmes ndihmës dhe inkurajimit** pasi që i njëjti ka inkurajuar persona të tjerë në kryerjen e akteve terroriste.

Andaj gjykata ka ardhur në përfundim se me këtë dënim, është e bindur se do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPK-së, dhe atë duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet, qëllimi i dënimit në kuptim të preventivës individuale, të ta parandaloi të pandehurin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventivës gjeneralë.

Vendimin lidhur me llogaritjen e masës së masën e paraburgimit në dënimin e shqiptuar për të akuzuarin K. P., gjykata e ka mbështetur në nenin 79 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësorë, u mor konform nenit 450 par 1 dhe 2 nën par 2.6 të KPPRK.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 360, 361 dhe 365 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
- Departamenti Special –
PS.nr.41/2021, me datën 24.12.2021

Kryetari i trupit gjykues
Lutfi SHALA

UDHËZIM JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.